



Datë: 16.05.2025

Numër Protokolli: 3236/2025

A.nr.574/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.574/2025 të datës 01.04.2025, të parashtruar nga ankuesja L.V, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridik ‘kontestim konkursi’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.574/2025 e datës 01.04.2025, e parashtruar nga ankuesja L.V.

A r s y e t i m

Ankuesja L.V (me tej referuar vetëm ankuese), më datë 01.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.574/2025 me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00016272, të datës 13.01.2025, për Grup i Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën ‘Asistent Administrativ’, Drejtortati i Regjistrimit të Automjeteve në Prishtinë Profesionale 3, të zhvilluar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 04.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa kjo e fundit, më datë 22.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr. 2141/2025 të datës 01.04.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për L.V; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.04.2025, dërguar

nga R.K, për A.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 574/2025, e datës 22.04.2025; Vendimi me numër protokolli 474, i datës 24.03.2025, për themelimin e Komisionit Ad hoc, i nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme; Konkursi me numër referencë RN00016272, i datës 13.01.2025; Njoftimi i datës 13.03.2025, i nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Lista e Aplikantëve; Vendimi me numër protokolli 327, i datës 27.02.2025, për shtyrjen e afatit për verifikim paraprak; Aplikacioni i L.V, Me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 25.06.1983; certifikatë për L.V, e vitit 2009; certifikatë për L.V, e vitit 2006; certifikatë për L.V, e vitit 2004; certifikatë për L.V, e vitit 2003.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 13.01.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016272 për emrin e grupit "Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës "Asistent Administrativ" në Drejtorinë e Regjistrimit të Automjeteve Prishtinë, Agjencia e Regjistrimit Civil klasa Profesional 3, numri i kërkuar një (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 14.01.2025 deri me 12.02.2025, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja.

Ankuesja me datë 01.04.2025 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kundërshtuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit, duke pretenduar se pas aplikimit tim me është dërguar një emali për pjesëmarrje në testim me shkrim, i cili do të mbahej me datën 28.03.2025 në orën 10:00 dhe se e kam konfirmuar pjesëmarrjen time përmes emalit dhe se isha e gatshme të marrë pjesë në test, me gjithë atë me datën 28.03.2025, kur kam shkuar në vendin e mbajtjes së testit me është refuzuar pjesëmarrja me arsyen se ora e testit ishte ndryshuar dhe sipas atyre me kishte ardhur një emali konfirmues për këtë ndryshim, dhe se kam qenë e befasuar me këtë informacion pasi që ju kam thënë personalisht dhe dua të theksoj edhe një her unë nuk kam pranuar një emal , nëpërmjet të cilit me është bërë me dije se ka ndryshuar koha e mbajtjes së testimit me shkrim.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..* si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: Ankesa në procedurë pranimiti. 1. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve dhe rrjedhimisht konstatoi se kandidati për pranim në Shërbim Civil, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtror ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar rrjedhimisht në kohën e parashtrimit të ankesës së ankueses me datë 01.04.2025, nuk është përfunduar ende procedura e pranimit sipas konkursit me numër të referencës RN00016272 gjegjësisht sipas përgjegjës në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme , del se procedura e*

rekrutimit për pozitën Asistent Administrativ " në Drejtorinë e Regjistrimit të Automjeteve në Prishtinë, Agjencia e Regjistrimit Civil", është në fazën e testimit me shkrim, andaj mbi bazën e kësaj rezultoni së ankesa e ankueses është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr 574/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses L.V;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së